



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM
Nr. 60, datë 24. 10. 2022

“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES DHE PJESËMARRJEN E BASHKISË SKRAPAR NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QËLLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 24. 10. 2022, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të nenit 9, nenit 14, pika 1, pika 5 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të Ligjit Nr.9901, date 14. 04. 2008, "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, VKM-së Nr. 302, date 11. 05. 2022, "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", Marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësiellës- Kanalizimeve, date 28. 09. 2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Skrapar dhe MEI, si dhe Bashkive: Berat, Kuçovë, Dimal, Poliçan

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësiellës- Kanalizimeve, datë 28. 09. 2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Skrapar dhe MEI, si dhe Bashkive: Berat, Kuçovë, Dimal, Poliçan.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë UK, Sh.A. Skrapar, që në përputhje me kushtet dhe dakordësinë e arritur në Marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësiellës- Kanalizimeve, date 28. 09. 2022, ku Bashkia do të jetë aksionar, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare UK, Sh.A. Skrapar, për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktor dhe noterjal me qëllim transferimin e plotë të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë asetet që aktualisht shoqëria ka, për tek shoqëria e re SKP-UK, që do të krijohet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Kryetari i Bashkisë Skrapar.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 11 vota pro , vota kundër - s'ka , vota abstenim – s'ka .
Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira SHKËMBI

